

VENDIM
Nr.632, datë 18.9.2003

**PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË,
FEMRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punëdhënësi, që punëson me kontratë të rregullt, me kohëzgjatje të paktën njëvjeçare, punëkërkues të papunë, femër, nga lista e zyrës së punësimit, përfiton një financim mujor të barabartë me 70 për qind të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme (kontributi i punëdhënësit), për të gjithë vitin e zbatimit të kontratës.

2. Kur kontrata e punës është me një kohëzgjatje të paktën dyvjeçare, punëdhënësi përfiton financimin mujor sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe një financim mujor të barabartë me 85 për qind të shumës së shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme (kontributi i punëdhënësit), financim i cili fillon në vitin e dytë të zbatimit të kontratës së punës dhe zgjat gjatë të gjithë vitit.

3. Kur kontrata e punës është me një kohëzgjatje të paktën trevjeçare, punëdhënësi përfiton financim mujor sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi dhe një financim të barabartë me 100 për qind të shumës së shpenzimeve për sigurime të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit), financim i cili fillon në vitin e tretë të zbatimit të kontratës së punës dhe zgjat gjatë të gjithë vitit.

4. Kur punësohen femra të trafikuar, femra mbi 35 vjeç, femra rome, femra me aftësi të kufizuara, vajza nëna, femra të divorcuara, me probleme sociale, financimi, sipas pikave 1, 2 dhe 3, i shtohet, sipas rastit, financimi si më poshtë vijon:

a) Në rastin e punësimit sipas pikës 1 financimi mujor shtohet deri në nivelin e katër pagave minimale në shkallë vendi;

b) Në rastin e punësimit sipas pikës 2, përveç përfitimit sipas shkronjës "a" të kësaj pike, financimi mujor shtohet deri në nivelin e gjashtë pagave minimale në shkallë vendi, financim i cili fillon vitin e dytë të kontratës;

c) Në rastin e punësimit sipas pikës 3, përveç përfitimit sipas shkronjave "a" dhe "b" të kësaj pike, financimi mujor shtohet deri në nivelin e tetë pagave minimale në shkallë vendi, financim i cili fillon vitin e tretë të kontratës.

5. Financimi i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 mund të jepet kur:

a) punëdhënësi, në çastin e kërkesës, nuk ka bërë pushime pa shkaqe të arsyeshme të punëmarrësve në 12 muajt paraardhës të kërkesës;

b) punëdhënësi ka derdhur rregullisht kontributet për sigurimet e detyrueshme për punëmarrësin e punësuar prej tij;

c) punëdhënësi nuk ka pasur shkelje të legjislacionit të punës të konstatuara nga Inspektorati Shtetëror i Punës;

ç) bilanci financiar i vitit të fundit është pozitiv.

6. Financimi i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3, ndërpritet kur punëdhënësi, pas përfitimit të financimit sipas këtij vendimi, bën pushime, pa shkaqe të arsyeshme të punëmarrësve të tjerë.

7. Fondet e pagesës së papunësisë, të kursyera nga dalja prej skemës së punëkërkuesve të papunë femra, që punësohen sipas këtij programi, transferohen në masën 100 për qind në buxhetin e programit.

8. Kostoja e këtij programi të përballohet nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale, zëri "Nxitja e punësimit".

9. Ngarkohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

